



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 1587 Prot.

Vlorë, më 29/05/2025

Lënda : *Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimet e Sekuestros)*

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE
DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

• Drejtorisë së Burimeve Mbështetëse



Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, nenit 162 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, kërkojmë nga ana Juaj shpalljen publike të tre akteve administrativ – Vendimet për rikuperimin me forcë të detyrimit doganor (vendimi i sekuestros) si vijon :

- Nr.1428 Prot., datë 14/05/2025, i materializuar për subjektin “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë.
- Nr.1429 Prot., datë 14/05/2025, i materializuar për subjektin “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë.
- Nr.1432 Prot., datë 14/05/2025, i materializuar për subjektin “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, me seli në Vlorë.

Jemi në pritje të konfirmimit nga ana Juaj për datën e shpalljes publike. Bashkëngjitur, gjeni kopje të tre akteve të lartcituara - gjithsej 6 (gjashtë) fletë.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1428 Prot.

Vlorë, më 14/05/2025

V E N D I M

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.38, me Nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 32,207 (Tridhjet e dymijë e dyqind e shtatë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor, si dhe penalitetit doganor në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 64,414 (Gjashtëdhjet e katërmijë e katërqind e katërmëdhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë (Novoselë, Rruga Nacionale Vlorë - Fier km.5, Slroftinë, Zona Kadastrale nr.3467, Nr.pasurie 31/1, Nr.Telefoni 0697501260), me administrator z.Roberto Dario, me status në QKB “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.808/3 Prot., datë 27/03/2025, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 18/04/2025, ora 2:59, me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.38, me nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025”, me lajmërimin publik, si dhe me shkresën Nr.808/4 Prot., datë 23/04/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcitur.

Personi juridik debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.38, me Nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.38, me Nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, "*Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës*",

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 96.621 (Nëntëdhjet e gjashtëmijë e gjashtëqind e njëzet e një) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.38, me Nr.808/2 Prot., datë 25/03/2025, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1629 Prot.

Vlorë, më 14/05/2025

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.37, me Nr.720/2 Prot., datë 25/03/2025, ka vendosur kontabilizimin e detyrimit doganor në shumën 67,725 (Gjashtëdhjet e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet e pesë) lekë, bazuar në nenin 250/4 të Kodit Doganor, si dhe penaltetit doganor në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën 135,450 (Njëqind e tridhjet e pesë mijë e katërqind e pesëdhjet e dy) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, me seli në Vlorë (Novoselë, Rruga Nacionale Vlorë - Fier km.5, Slrofotinë, Zona Kadastrale nr.3467, Nr.pasurie 31/1, Nr.Telefoni 0697501260), me administrator z.Roberto Dario, me status në QKB “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.720/3 Prot., datë 27/03/2025, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 18/04/2025, ora 3:01, me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.37, me nr.720/2 Prot., datë 25/03/2025”, me lajmërimin publik, si dhe me shkresën Nr.720/4 Prot., datë 23/04/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcitur.

Personi juridik debitor “Weldings” sh.p.k me NUIS M12403010F, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.37, me Nr.720/2 Prot., datë 25/03/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.37, me Nr.720/2 Prot., datë 25/03/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *"Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës"*,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik "Weldings" sh.p.k me NUIS M12403010F, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 203,175 (Dyqind e tremijë e njëqind e shtatëdhjet e pesë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të detyrimeve doganore Nr.37, me Nr.720/2 Prot., datë 25/03/2025, të Degës së Doganës Vlorë.

KRYETAR

Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1432 Prot.

Vlorë, më 14/05/2025

VENDIM

“Për Rikuperimin me Forcë të Detyrimit Doganor që debitori - subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, me seli në Vlorë, ka ndaj Degës së Doganës Vlorë”.

Dega e Doganës Vlorë, me Vendimin e saj Nr.44, me Nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025, ka vendosur kontabilizimin e penalitetit doganor në shumën 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, bazuar në nenin 257/1/b të Kodit Doganor, ndaj subjektit debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, me seli në Vlorë (Lagjia “Bashkimi”, Rruga “Sado Koshena”, Nr.10; Nr. Tel : 0692024399), me status në QKB “Aktiv”.

Ky Vendim i është njoftuar subjektit debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K me anë të Shërbimit Postar, me shkresën nr.908/3 Prot., datë 04/04/2025, me lëndë “Njoftim Vendimi”. Gjithashtu, Dega e Doganës Vlorë ka proceduar edhe me njoftimin elektronik të vendimit, me email-in e datës 18/04/2025, ora 3:09, me lëndë “Njoftim i aktit administrativ – vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore nr.44, me nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025”, me lajmërimin publik, si dhe me shkresën Nr.908/4 Prot., datë 23/04/2025, me lëndë “Kërkesë për ekzekutimin vullnetar të detyrimeve doganore”, me anë të së cilës, Dega e Doganës Vlorë i ka rikërkuar subjektit debitor ekzekutimin vullnetar edhe të aktit administrativ të lartcitur.

Personi juridik debitor “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, i njoftuar, nuk është paraqitur për të paguar vullnetarisht detyrimet e përcaktuara në Vendimin Nr.44, me Nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025, si dhe nuk ka ushtruar ankim administrativ pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave në Tiranë, në zbatim të nenit 282 të Kodit Doganor.

Në këto kushte, në zbatim të Vendimit Nr.44, me Nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025, me qëllim marrjen e masave përkatëse për rikuperimin me forcë të detyrimeve doganore, që Debitori - subjekti “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, ka ndaj Degës Doganore Vlorë, bazuar në nenin 280 të Kodit

Doganor, nenin 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile si dhe Udhëzimin Nr.15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, *“Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”*,

V E N D O S A :

- Të sekuestrohen vlerat monetare, kreditë, sendet me vlerë të çmuar, dokumentat me anë të të cilave bëhet pagesa, valutë e huaj e depozituar në bankë, që i përkasin debitorit, personit juridik - “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, apo garantuesve, që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Të sekuestrohen mallrat, pasuritë e tundshme ose të patundshme, që i përkasin debitorit, personit juridik - “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, apo garantuesit/garantuesve që kanë detyrime ndaj debitorit.
- Sekuestrimi i mësipërm të kryhet deri në masën që të bëhet i mundur plotësimi i detyrimeve që debitori, personi juridik “SIMAK SHOES” sh.p.k me NUIS L56517201K, i ka Degës së Doganës Vlorë, në shumën totale 50,000 (Pesëdhjetëmijë) lekë, sipas aktit administrativ - Vendimit të kontabilizimit të penalitetit doganor Nr.44, me Nr.908/2 Prot., datë 03/04/2025, të Degës së Doganës Vlorë.

K R Y E T A R

Artan Bedinaj